



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 31003-317-2022 i Regj. Themeltar
Nr.00-2022- 3835 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

**Asim VOKSHI - Kryesues
Arbena AHMETI - Anëtare
Gentian MEDJA - Anëtar**

në datën 24.11.2022 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen me nr. 31003-317-2022 akti që i përket palëve:

KËRKUES: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

OBJEKTI: “Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës”

BAZA LIGJORE: Neni 13 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar).

në çështjen me palë:

KËRKUES: Marjan Rroku

PALË E INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat
Institucioni i Vuajtjes së Dënimeve Penale

OBJEKTI: Rivendosje e të drejtave të të burgosurit.

BAZA LIGJORE: Neni 470 i Kodi i Procedurës Penale, Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e paraqitur nga gjyqtari Asim Vokshi dhe diskutoi në dhomë këshillimi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga dosja gjyqësore rezulton se pala kërkuese Marjan Rroku, i cili po vuan dënimin pranë IEVP Burrel, është dënuar me burgim të përjetshëm me vendimin nr. 328 datë 02.05.2002, për veprën penale të vrasjes dashje. Ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 18.09.2002.

2. Ky i dënuar i është drejtuar me Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me kërkesë për rivendosjen e të drejtave të tij si i burgosur. Në thelb të kërkimeve të tij, pretendon cenimin e të drejtave që lidhen me punësimin, rehabilitimin social dhe ri-integrimin, komunikimin me familjarët e tij apo kushte të jetesës në këto institucione.

3. Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është regjistruar kërkesa e të dënuarit me burgim të përjetshëm, me objekt rivendosjen e të drejtave të të burgosurit. Kërkuesi ka paraqitur pretendime lidhur me të drejtat e tij për mënyrën e fjetjes, të drejtën për t'u marrë me aktivitete krijuese dhe rehabilituese.

4. Sipas kërkuesit këto ankesa i janë drejtuar vetë IEVP Burrel, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrisë së Drejtësisë sipas neneve 59 dhe 80 të Ligjit Nr. 81/2020. Kërkuesi nuk ka gjetur zgjidhje në rrugë administrative, për këtë arsye i është drejtuar gjykatës me kërkesën për rivendosje të të drejtave të tij. Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar gjykatës, me kërkesën objekt gjykimi.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat**, me vendimin nr. 39, datë 28.06.2022 ka vendosur:

“Shpalljen e mos kompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për gjykimin e çështjes penale, Nr. 39, Regjistri Themeltar, datë regjistrimi 26.04.2022. Urdhërohet dërgimi i akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashke me vendimin përfundimtar ose jo përfundimtar.”

5.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se: “kërkimet e Z. Rroku nuk lidhen me ankesa në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, për te cilin po vuan dënimin e tij por me kërkesa që lidhen me mosveprimin e IEVP Burrel dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që nuk po respekton kërkesat e Ligjit nr. 81/2020. Natyra juridike e mosmarrëveshjes objekt gjykimi i të drejtës administrative dhe jo asaj të juridiksionit të përgjithshëm. Gjykata vlerëson se çështja në shqyrtim është e natyrës administrative dhe për këtë shkak, kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e saj është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi çështja është e natyrës administrative pasi përmes kësaj kërkesë, kërkuesi kërkon detyrimin e një organi publik që të kryejë një veprim administrative.”

6. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. s'ka, datë 06.10.2022, ka vendosur:

“T'i parashtrijë Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen në lidhje me konfliktin e kompetencës. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.”

6.1. Kjo gjykatë ka arsyetuar se: “[...] në vlerësim të akteve të dosjes gjyqësore, objektit dhe shkakut të padisë çmon se, nuk është kompetente për gjykimin e kësaj çështje. Në çështjen objekt gjykimi, vlerësohet se nuk përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mësipërme, në mënyrë që mosmarrëveshja të përfshihet në lëndën e gjykimit administrativ. Pretendimi i kërkuesit nuk është një çështje që i përket interesit publik, por dukshëm kanalizohet si interes privat i një shtetasi të dënuar për të përfituar nga të drejtat e parashikuara në Ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me mosveprimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, nga interpretimi dhe vlerësimi i drejtë i shkakut të kërkimit, kërkuesi në thelb kërkon

t'i njihet dhe garantohen të drejtat e parashikuara në Ligjin Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Kërkuesi nuk padit organin publik dhe as kërkon kryerjen e ndonjë veprimi administrativ prej tij, apo ndryshimin e një akti administrativ. I EVP Burrel në këtë gjykim paraqitet në cilësinë e personit të interesuar dhe jo palës së paditur, pikërisht se natyra e mosmarrëveshjes nuk lidhet drejtpërdrejtë me mosveprimin e saj, por me njohjen në thelb të së drejtës materiale penale të parashikuar nga Ligji Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Së pari, pavarësisht nga formulimi që i është bërë objektit të padisë, kërkimi i palës paditëse për detyrimin e organit publik të kryejë veprime të caktuara administrative në drejtim të respektimit të të drejtave të tij nuk është kërkimi kryesor i padisë, pasi shkaku i kërkesës është I lidhur pazgjidhshmërisht me të drejta që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Kërkesa në shqyrtim ka për shkak respektimin e të drejtave të tij gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Me ekzekutim të vendimit penal në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë apo me ekzekutim të menjëhershëm. Kjo veprimtari rregullohet nga legjislacioni penal. Në vijim të sa më sipër dhe në rrethanat kur marrëdhënia juridike për shkak të së cilës ka lindur konflikti, ka në themel problematika që kanë të bëjnë me mënyrën si po ekzekutohet vendimi penal. Kjo gjykatë vlerëson se në përcaktimin e kompetencës lëndore gjykata duhet t'i referohet dispozitave të Kodit Penal dhe Ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të zbatueshme për çështjen konkrete, dhe që shërbejnë si bazë për njohjen e të drejtave të pretenduara nga paditësi në situatën e heqjes së lirisë në institucionet e vuajtjes së dënimit penal. Shkaku i kërkesëpadisë i referohet rregullave të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë së gjykatës. Kërkesat e paditësit kanë në thelb ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme të institucioneve të vuajtjes së dënimit penal që pazgjidhshmërisht kanë në thelb vendimin penal prej të cilit buron sanksioni i heqjes së lirisë. Institucioni i ekzekutimeve të vendimeve penale, i cili kërkohet të detyrohet nga paditësi, është organ publike që operon dhe funksionon në bazë të legjislacionit penal dhe aktet nënligjore të brendshme të këtyre institucioneve. Funksionimi, administrimi, si dhe rregullat që përcaktojnë elementet e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen sipas legjislacionit penal në fuqi. Rregullorja e brendshme e këtyre institucioneve, ka dale mbi bazë të rregullores së burgjeve, që përcakton organizimin, disiplinën e brendshme dhe kërkesat e trajtimit në kushtet e institucionit, elemente këto që tregojnë disiplinimin e këtyre institucioneve që lidhen drejtpërdrejtë me ligjin penal. Neni 470 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton qartë kompetencën e gjykatës së vendit të ekzekutimit lidhur me të gjitha kërkesat që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit po kështu dhe nenet 59 dhe 80 të ligjit Nr. 81/2020. Neni 480 i Kodi i Procedurës Penale, përcakton se në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj. Konkretisht, nenet e sipërcituara të këtij ligji të posaçëm, detyrojnë gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm të marrë çështjen objekt shqyrtimi në gjykim. Gjykata vlerëson se referuar objektit të kërkesës dhe shkakut ligjor të saj, para saj është paraqitur një kërkesë që ka në themel pretendimet për mënyrën e ekzekutimit të vendimit. Vendimmarrja dhe sjellja e I EVP Burrel, e pretenduar e gabuar nga kërkuesi, është shkaku për të cilin ai I drejtohet gjykatës me kërkesë, por jo objekti I kërkesës. Kërkuesi ka paraqitur para gjykatës kërkesë për plotësimin e ankesave të tij dhe në lidhje me këtë kërkesë është kompetente gjykata e vendit të ekzekutimit, që në rastin konkret është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Kjo gjykatë, vlerëson se nuk duhet të konfondohet, objekti i kërkesës penale me shkaqet që e kanë çuar kërkuenin të investojë gjykatën me një kërkesë të natyrës administrative. Shkaqet që kanë detyruar kërkuenin t'i drejtohet gjykatës derivojnë nga mënyra si vendimi penal po ekzekutohet referuar rregullave të I EVP Burrel. Nga sa më sipër Gjykata Administrative e Shkallës

së Parë Tiranë, çmon se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.”

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), vlerëson se vendimi nr. 39, datë 28.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, prandaj çështja do të dërgohet po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, si gjykata që sipas ligjit procedural e ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj.

8. Kolegji e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

9. Kolegji në përcaktimin e kompetencës i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative dhe se kujt i përket zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në rastin në shqyrtim, Kolegji e vlerëson të gabuar arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Gjykata nuk ka përcaktuar drejtë natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi, duke mos bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore, që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës.

10. Kolegji, vlerëson se në analizë të kërimit të palës kërkuese dhe shkakut ligjor ku mbështetet kërkitimi, rezulton se jemi përpara një kërkitimi që i përket kontrollit nga gjykatat penale sipas Kodit të Procedurës Penale, pasi pretendimi i kërkuesit është një çështje që i përket zbatimit të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Pretendimi i palës kërkuese nuk lidhet me mosveprimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, por nga interpretimi dhe vlerësimi i drejtë i shkakut të kërimit, kërkuesi në thelb kërkon t’i njihet dhe garantohen të drejtat e parashikuara në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, pra me njohjen në thelb të së drejtës materiale penale të parashikuar nga ky ligj.

11. Kolegji thekson se kërkitimi i palës paditëse nuk është për detyrimin e organit publik të kryejë veprime të caktuara administrativ, por shkak i kërkesës është i lidhur me të drejta që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Pra, kërkesa në shqyrtim ka për objekt respektimin e të drejtave të të burgosurit gjatë vuajtjes së dënimit me burgim dhe me ekzekutimin e vendimit penal në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, në zbatim të urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë apo me ekzekutim të menjëhershëm. Kolegjit vlerëson se kjo marrëdhënie rregullohet nga legjislacioni penal dhe në thelb këto pretendime kanë të bëjnë me mënyrën si po ekzekutohet vendimi penal, për rrjedhojë gjykatat duhet t’i referohet dispozitave të Kodit Penal dhe Ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të zbatueshme për çështjen konkrete.

12. Nga ana tjetër, ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 59 të tij ka përcaktuar afatet e shqyrtimit të ankesës dhe të kërkesës së të dënuarit, konkretisht:

“1. Organet kompetente, sipas këtij ligji, shqyrtojnë ankesën dhe kërkesën sa më parë, por jo më vonë se 14 ditë nga paraqitja, përveç rasteve kur ky ligj parashikon afate të posaçme për shqyrtimin e tyre.

2. Kundër vendimit të dhënë sipas pikës 1 të këtij neni, ose në rastin kur organet kompetente nuk shprehen me vendim, i burgosuri ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i burgosuri ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji.

3. I burgosuri ka të drejtë të paraqesë kërkesa dhe ankesa pranë Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Rregullat, procedurat dhe afatet e shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave nga Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.”

13. Ndërsa në nenin 80 të ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet se: “Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale”.

14. Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, Kolegji thekson se ligji i posaçëm e ka përcaktuar qartësisht rrugën që ndiqet nga i burgosuri për pretendimet objekt shqyrtimi, për pasojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat nuk kishte përse të krijonte një konflikt për kompetencën, kur kjo e fundit është përcaktuar qartësisht në nenin 80 të ligjit nr. 81/2020, sipas të cilit kompetenca është përket gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, e cila shqyrton çështjen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

15. Mbështetur sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të priset dhe çështja t'i dërgohet po asaj gjykate për të vazhduar gjykimin.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar),

V E N D O S I:

1. Rregullimin e kompetencës lëndore të gjykatave në mosmarrëveshje, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, si gjykatë kompetente.

2. Prishjen e vendimit nr. 39 datë 28.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimin.

Tiranë, më 24.11.2022